



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P. 501/2016

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Gentian Këri	Kryetar
Spiro Kuro	Zv/Kryetar
Juliana Hoxha	Anëtar
Leonard Gremshi	Anëtar
Hektor Balluku	Anëtar

Në mbledhjen e datës 30.06.2016 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimin e vendimit KVO-së për skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Flonja” sh.a. për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-33957-04-17-2016 me objekt “Ndërtesat Mirëmbajtje” me fond limit 11.376.838 lekë pa TVSH, procedurë e zhvilluar në datën 11.05.2016 nga autoriteti kontraktor, Spitali Psikiatrik Sadik Dinci Elbasan.

Ankimues:

“Flonja” sh.p.k
Rruga “Irfan Tomini”,P.20, Ap.3, Shk.2

Autoriteti Kontraktor:

Spitali Psikiatrik Sadik Dinci Elbasan
Lagjia Haxhias, Rruga Ismail Zyma Elbasan.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”,i ndryshuar;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorët e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”;

I.4. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës të operatorit ekonomik ankimes.

Public Health Sector

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 17.04.2016 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*” me Nr. REF-33957-04-17-2016 me objekt “*Ndërtesat Mirëmbajtje*” me fond limit 11.376.838 lekë pa TVSH, procedurë e zhvilluar në datën 11.05.2016 nga autoriteti kontraktor, Spitali Psikiatrik Sadik Dinci Elbasan.

II.2 . Në datën 11.05.2016 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 25.05.2016 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezultoi si më poshtë vijon:

- Flonja	7,325,280.00	I skualifikuar
- Elkri&Co	7,406,040.00	I skualifikuar

- Delia Impex	7,803,380.00	I skualifikuar
- Murati	7,889,680.00	I kualifikuar
- Ina	7,897,460.00	I kualifikuar
- Altec	8,532,000.00	I skualifikuar
- Mandi 1	8,258,600.00	I skualifikuar
- Blerimi	9,094,006.00	I kualifikuar
- Meni	9,248,340.00	I skualifikuar
- Fitore	9,277,300.00	I skualifikuar
- Avduli	9,360,230.00	I kualifikuar
- Erges Mat	9,445,050.00	I kualifikuar
- Nika	9,523,978.00	I skualifikuar
- Shamo Construction	9,666,650.00	I skualifikuar
- Tea-D	9,949,040.00	I skualifikuar
- Ndërtimi	9,971,000.00	I kualifikuar

II.3.1. Operatori ekonomik ankimes “Flonja” sh.p.k. është njoftuar për skualifikimin e ofertës së tij me argumentin se : *“[...]Operatori ekonomik skualifikohet pasi listpagesat përkatëse për muajt Janar-Dhjetor 2015 dhe Janar-Shkurt 2016 nuk janë të konfirmuara nga Administrata Tatimore [...]”*

II.4. Në datën 30.05.2016 operatori ekonomik ankimes “Flonja” sh.a. ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij.

II.4.1. Në ankesën drejtuar autoritetit kontraktor, pala ankimese kundërshton vendimin e KVO-së me argumentat se: *“[...]Shoqëria jonë nuk është dakord me skualifikimin pasi listpagesat e depozituara janë të konfirmuara nga administrata tatimore. Me digjitalizimin e shërbimeve të administratës tatimore pra me vënien në punë të sistemit elektronik të deklarimeve online vërtetimi nga administrata tatimore jepet në formën e numrit serial që i korespondon çdo listpagese të deklaruar në këtë mënyrë. Sipas legjislacionit në fuqi listpagesat e sigurimeve shoqërore deklarohen në formë elektronike dhe dokumentacioni i deklaruar vlerësohet i plotë nga ana faktike dhe dokumentare. [...]”*

II.5. Në datën 02.06.2016 autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr.ska prot datë 02.06.2016 i kthen përgjigje palës ankimese duke mos pranuar ankesën.

II.6. Në datën 06.06.2016 operatori ekonomik ankimes ka paraqitur ankesë me të njëjtin objekt pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

II.7. Në datën 16.06.2016 autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr.350/2 datë 15.06.2016 ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin e kërkuar në lidhje me procedurën e prokurimit të sipërcituar.

III Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Flonja ” sh.a. mbi skualifikimin e ofertës së tij me arsyetimin se “[...]Operatori ekonomik skualifikohet pasi listpagesat përkatëse për muajt Janar-Dhjetor 2015 dhe Janar-Shkurt 2016 nuk janë të konfirmuara nga Administrata Tatimore [...]”. Komisioni i Prokurimit Publik vëren se :

III.1.1. Në Shtojcën 7 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, “Kapaciteti teknik” të procedurës së prokurimit objekt ankimi është kërkuar: “[...]Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te punesuar mesatarisht jo me pak se 10 (dhjete) punonjes per periudhen Janar - Dhjetor 2015 dhe Janar- Shkurt 2016. Ne lidhje me kete pike operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese :Vertetim nga Administrata Tatimore ose Dega e Sigurimeve Shoqerore per numrin e punonjesve te siguruar per periudhen Janar - Dhjetor 2015 dhe Janar – Shkurt 2016. **Listepagesat perkatese per muajt Janar - dhjetor 2015 dhe Janar – Shkurt 2016 te konfirmuara nga Administrata Tatimore. [...]**”

III.1.2. Për plotësimin e kriterit të mësipërm, operatori ekonomik “Flonja ” sh.p.k. ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (S.P.E.) dokumentacionin e mëposhtëm:

- i. Listëpagesat për periudhën Janar 2015-Dhjetor 2015 të gjeneruara nga Sistemi i online i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve;
- ii. Listëpagesat për periudhën Janar 2016-Shkurt 2016 të gjeneruara nga Sistemi i online i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve;

III.1.3. Në nenin 65 pika 6 e Ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008, “Për procedurat Tatimore”, i ndryshuar, i cili parashikohet se: “[...]Këshilli i Ministrave përcakton afatet kohore për dorëzimin e deklaratave tatimore e të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike.[...]”

Në njoftimin e datës 14.01.2013 të bërë nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, ndër të tjera përcaktohet se “Duke filluar nga periudha tatimore Janar 2013, deklarimi i listëpagesave E-Sig 025 dhe Formularëve të ndryshimit të numrit të punonjësve E-Sig027 do të kryhen vetëm në mënyrë elektronike”

Në VKM nr. 922, datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumentave të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, neni 1, pika “xii” parashikohet se: “Dorëzimin e detyrueshëm, vetëm nëpërmjet formës elektronike, të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, objekt i këtij vendimi, me të cilat nënkuptohen:

xii) deklarata “Listëpagesë e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi”.

Gjithashtu në Nenin 2 të VKM 922/2014 parashikohet se *“Çdo tatimpagues është i detyruar të bëjë dorëzimin e deklaratave dhe dokumenteve tatimore, të parashikuara në shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 1, të këtij vendimi, vetëm nëpërmjet formes elektronike, duke filluar nga data 1 janar 2015, sipas afateve ligjore të përcaktuara dhe formës së deklaratës apo të dokumentit të miratuar me udhëzim të ministrit të Financave.”*

III.1.4. Pretendimi i autoritetit kontraktor se listëpagesat e paraqitura nga operatori ekonomik ankimues “Flonja” sh.p.k. janë të pa konfirmuara nga administrata tatimore nuk qendron pasi, referuar dispozitës ligjore të sipërcituar, si dhe praktikës tashmë të konsoliduar të Komisionit të Prokurimit Publik në vendime analoge , deklarimi i listëpagesave Esig 025 nga periudha tatimore Janar 2013 kryhet vetëm në mënyrë elektronike. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik ankimues ka përmbushur të gjithë detyrimet ligjore për paraqitjen e listëpagesave për periudhën e kërkuar nga autoriteti kontraktor. Për periudhën Janar 2015-Dhjetor 2015 si dhe Janar 2016- Shkurt 2016, operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar listëpagesat pranë administratës tatimore në përputhje me VKM nr.55 datë 03.02.2010 *“Për Deklarimin e Detyrueshëm të Deklaratave Tatimore dhe të Dokumenteve të Tjerë Tatimore vetëm Nëpërmjet Formës Elektronike”*. Ndërkohë K.P.P gjykon se operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar listëpagesat për periudhën Janar 2015-Shkurt 2016 në përputhje me kërkesat e VKM nr. 922, datë 29.12.2014 *“Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumentave të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formes elektronike”*. Kuadri ligjor i mësipërm parashikon se dorëzimi i dokumenteve tatimore (përfshirë edhe listëpagesat) dorëzohen vetëm në formë elektronike. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se është detyrë e operatorëve ekonomikë të përmbushin detyrimet që rrjedhin nga kuadri ligjor në fuqi, (në rastin konkret detyrimet tatimore) vetëm në përputhje me kërkesat e këtij të fundit. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se përmes dokumentacionit të dorëzuar në S.P.E pala ankimuese ka përmbushur kërkesën e autoritetit kontraktor.

III.1.5. Në nenin 46, pika 1 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përparim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”*

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit... .”*

Sa më sipër pretendimi i ankimuesit qëndron.

Në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik”*,

të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Flonja” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-33957-04-17-2016 me objekt “Ndërtesat Mirëmbajtje” me fond limit 11.376.838 lekë pa TVSH, procedurë e zhvilluar në datën 11.05.2016 nga autoriteti kontraktor, Spitali Psikiatrik Sadik Dinci Elbasan.
2. Të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Flonja” sh.p.k. dhe të korrigjojë shkeljet, duke e kualifikuar këtë operator ekonomik.
3. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijëni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Flonja” sh.p.k.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1345 Protokolli; Datë 06.06.2016;

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar
Spiro Kuro

Anëtar
Juliana Hoxha

Anëtar
Leonard Gremshi

Anëtar
Hektor Balluku

Kryetar
Gentian Këri